

Nr. i Dokumentit: 14.06.2016-01

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË
ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, Qershor 2016

Deloitte Kosova sh.p.k. ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushteti Lokal ('Ministria') për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në emër të zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe certifikojnë rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni i ZAP-it është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratën publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe me praktikën e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.....	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	24
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara	25
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak	28
Shtojca IV: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave.....	32

Përmbledhje e përgjithshme


Hyrje

Deloitte Kosova sh.p.k. ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ('Ministria' ose 'MAPL') për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015, në emër të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm ("ZAP").

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ('Ministria') për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Deloitte Kosova sh.p.k.. Ne do të donim të falënderojmë Ministrin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me Parimet dhe Udhëzimet Themelore të Auditimit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):




Niveli i punës së kryer nga ne për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Procesi i vetëvlerësimit dhe përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk janë adresuar ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e Organizatës.



Ministri duhet ta zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që procesi i vetëvlerësimit dhe rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza të rregullta (shih çështjet 1, 2 dhe 3).

Ekzekutimi i buxhetit gjatë vitit 2015 nuk ishte në nivelin e pritur. Buxheti total për vitin ishte shpenzuar 85%.



Ministri duhet ta aplikoj një vlerësim të detajuar në lidhje me nivelin e ekzekutimit të buxhetit, veçanërisht tek investimet kapitale dhe ndërmerre masa për evitim të mangësive (shih çështjen 6).

Edhe pse në disa fusha kontrollet e brendshme janë efektive - ekzistojnë dobësi në disa sisteme të rëndësishme financiare duke përfshirë prokurimin .



Ministri duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të prokurimit dhe fushave tjera brengosëse të theksuara në këtë raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjen 7).

Përgjigja e Ministrit – auditimi 2015

Ministri ka marrë në konsideratë të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit. Komentet e Ministrit për çështjet për të cilat nuk jemi pajtuar janë dhënë në detaje në Shtojcën IV.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata për prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PVF-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkangjitura të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ("Ministria") të cilat përmbajnë Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme dhe Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015, dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe shënimeve tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), për "Raportimin Financiar Sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme" dhe me Rregulloren MF – Nr.03/2013 "Për Pasqyrat Financiare Vjetore të organizatave buxhetore". Kjo përgjegjësi përfshinë hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e një kontrolli të brendshëm për përgatitjen dhe prezantimin e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Parimet dhe Udhëzimet Themelore të Auditimit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA). Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të arritur një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve.

Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojnë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të kualifikuar të auditimit.

Baza për opinion të kualifikuar

1. Regjistri i pasurive kapitale i mbivlerësuar. Ministria realizon investime në komuna. Shuma totale e asetëve që është paraqitur më datë 31 dhjetor 2015, në Shënimin 31: Përmbledhja e pasurive jo-financiare kapitale (me vlerë mbi 1,000 €) në posedim të organizatës buxhetore është 7,024,524€. Sipas dokumentacionit që kemi ekzaminuar, dhe rishikimit të informacioneve që kemi marrë nga Ministria, kemi vënë re që prej këtyre asetëve, afërsisht 142,568€ janë pasuri në pronësi dhe shfrytëzim të Ministrisë, ndërsa shuma tjetër prej 6,883,956€ janë investime kapitale që janë realizuar në Komuna, të cilat ende paraqiten si pasuri e Ministrisë, në vend se të barteshin tek komunat përkatëse, sipas kërkesave të Rregullorës së MF. Nr. 02/2013
2. Zhvlerësimi i pasurisë. Regjistri i pasurive kapitale mbi 1,000 € nuk përmban datën e saktë kur pasuria është vënë në funksion, por vetëm vitin e blerjes së pasurisë. Si rrjedhojë, ne nuk kemi mundur të përcaktojmë nëse zhvlerësimi i llogaritur nga sistemi dhe vlera neto, respektivisht, e pasurive e paraqitur në Shënimin 31 është e saktë.
3. Për më tepër, duke pas parasysh që Ministria financon projekte kapitale në Komuna, sipas informacioneve që kemi ekzaminuar, regjistri i pasurive mbi 1,000 €, përmbanë pasuri që në kohën e investimit duhet të ishin regjistruar si pasuri në vijim, sipas kërkesave të Rregullorës së MF. Nr. 02/2013, dhe pas finalizimit dhe dorëzimit të kalonin në kategori përkatëse. Mirëpo pasuritë e tilla me rastin e pagesës u regjistruan menjëherë në kategorinë përkatëse dhe jo fillimisht në kategorinë e investimeve në vijim, dhe rrjedhimisht ishin kalkuluar shpenzime të zhvlerësimit, para se pasuria të fillonte të shfrytëzohej. Kjo rezultoi në pasuri me vlerë të nënvlerësuar dhe shpenzime të zhvlerësimit të mbivlerësuar. Efekti i tillë ishte e pamundur të vlerësohej duke pas parasysh mangësitë në regjistrin e pasurive.
4. Inventarizimi dhe vlerësimi i pasurive jo- financiare. Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 Ministria nuk ka kryer inventarizimin e pasurive siç kërkohet me Rregulloren MF-Nr. 02/2013 “Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore” e cila kërkon që “Organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë”.

Për më tepër, duke pas parasysh që rezultatet e inventarizimi të vitit 2014 nuk janë azhurnuar në sistem, balancat bartëse të pasurive nga viti 2014 në vitin 2015 mund të përmbajnë pasaktësi. Ne kemi bërë verifikimin fizik të disa pasurive në objektin e Ministrisë dhe kemi vënë re që lista e aseteve të Ministrisë përmbanë pasuri që nuk ekzistojnë dhe janë bartur në organizata tjera buxhetore.

Opinion i kualifikuar

Sipas mendimit tonë, përveç efekteve të mundshme të çështjeve të referuara në paragrafët 1 - 4, siç përshkruhet në paragrafin Baza për opinion të kualifikuar, pasqyrat financiare të Ministrisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me SNKSP për "Raportimin Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme" dhe me Rregulloren MF - Nr. 03/2013 "Për Pasqyrat Financiare Vjetore të organizatave buxhetore".

Çështje tjetër

Pasqyrat financiare të Ministrisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2014, janë audituar nga auditor të tjerë të cilët kanë shprehur opinion të pakualifikuar për këto pasqyra në qershor të vitit 2015.

Deloitte Korova Buj-L.

Prishtinë, Kosovë
30 qershor 2016

1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Ministria kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116 dhe Ligjin nr. 04/L-194.
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€.
- Raportet për borxhet e papaguara;
- Planin preliminar dhe final të prokurimit; dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto.

1.4 Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime lidhur me PVF-të.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MAPL-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballlet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetëvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse.

- Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të: fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe

-
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuarra përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve.

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MAPL-së veçanërisht në lidhje me menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial, sic janë detajuar në seksionin 1.8 dhe 1.9 më poshtë. Sa i përket rekomandimeve të auditimit të jashtëm, Ministria ka përgatitur një plan veprimi për to, ndërsa për rekomandimet e auditorit të brendshëm, plani i veprimit nuk është i plotë dhe përfshin vetëm 2 nga 4 raportet e auditorit.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti i auditimit për PVF-të të vitit 2014 të MAPL-së ka rezultuar në 13 rekomandime kryesore. MAPL kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të implementohen të gjitha rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2015, 3 rekomandime janë implementuar; 8 janë adresuar dhe 2 nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 –Implementimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura	Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë implementuar nga MAPL.
Rreziku	Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kanë rezultuar në: • Mangësi në planifikimin dhe realizimin e buxhetit; • Jo efikasiteti i vazhdueshëm organizativ dhe vlera e dobët për para në praktikën e prokurimit.
Rekomandimi 1	Ministri duhet të sigurojë që është zbatuar dhe marrë parasysh plani i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga auditori, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

2.4 Lista kontrolluese e vetëvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetë-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetëvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MAPL-në më poshtë. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetëvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 – Lista kontrolluese e vetëvlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar katër pyetje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me komponentet. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Përderisa dokumentimi i rreziqeve në regjistrin përkatës është konsideruar si i vendosur në pyetësor, një regjistër i tillë nuk është përpiluar fare për vitin 2015.
2. Lidhur me procesin e prokurimit, komisioni për hartimin e specifikacionit teknik konsiderohet si i vendosur nga MAPL, mirëpo dëshmitë që na janë dhënë nuk e mbështesin këtë konkluzion.
3. Lidhur me përgatitjen e raporteve për zotimet dhe raportet për ekzekutimin e buxhetit, MAPL është përgjegjës se përgatiten në baza javore, mirëpo dokumentimet në mbështetje të këtij konkluzioni janë të dobëta.

Rreziku Aranzhimet e dobëta të qeverisjes i dobësojnë proceset strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit MAPL operon dhe sfidat me të cilat përballlet.

2.5.1 Vlerësimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015, MAPL nuk ka përgatitur regjistrin e rreziqeve.

Çështja 3 – Dobësi në Kontrolllet Menaxheriale – Prioriteti i lartë

E gjetura	MAPL nuk ka përgatitur regjistrin e rreziqeve për vitin 2015.
Rreziku	Mos përgatitja e regjistrit të rreziqeve është në kundërshtim me ligjet në fuqi, dhe mund të qojë në dobësimin e aftësive planifikuese të Ministrisë.
Rekomandimi 3	Ne rekomandojmë që Ministri të sigurohet se MAPL është në pajtim me të gjitha kërkesat për raportim, duke përfshirë edhe përgatitjen e regjistrit të rreziqeve.

2.5.2 Raportimi Menaxherial

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet.

Çështja 4 – Dobësi në Kontrolllet Menaxheriale – Prioriteti i mesëm

E gjetura	Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të MAPL-së ka nxjerrë në pah se edhe përkundër raportimeve të rregullta formale nga njësit vartëse për fushën e realizimit të buxhetit, prokurimit, subvencioneve, dhe personelit, ato nuk janë shfrytëzuar në mënyrë efektive nga menaxhmenti për të parandaluar gabimet sistematike në këto fusha.
Rreziku	Cilësia e dobët e raportimit financiar dhe të aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë e ka reduktuar aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e MAPL-së në mënyrë pro aktive si dhe ka ulur efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonojë veprimet e nevojshme për ti adresuar ato. Ngjashëm mund të rezultojë në ofrimin e shërbimeve të dobëta.
Rekomandimi 4	Ministri duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit tek menaxhmenti i lartë, dhe se raportimet përdoren nga menaxhmenti me qëllim të parandalimit të gabimeve.

2.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NJAB dhe dy auditor. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të MAPL-së dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

E gjetura	Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NJAB: 1. Vetëm katër prej gjashtë raporteve të planifikuara për vitin 2015 janë kryer, ndërsa përveq tyre është kryer edhe një auditim add hoc. 2. Plani për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm përfshin vetëm 3 nga 4 raportet e lëshuara nga auditori i brendshëm gjatë vitit 2015.
Rreziku	Një program jo i plotë i auditimit ndikon në mos identifikimin dhe mos adresimin e dobësive në kontrole duke rezultuar në jo efikasitet operativ dhe humbje financiare për Ministrinë. Mos adresimi i rekomandimeve do të përkeqësojë situatën.
Rekomandimi 5	Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, Ministri duhet të sigurojë angazhim më të madh të Komitetit të Auditimit. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm dhe rezultatet e auditimit të brendshëm. Gjithashtu duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

Sa i përket MAPL-së, prokurimi mbetet shqetësim i madh, ku nuk janë duke u zbatuar rregulloret duke rezultuar në vlerë të dobët të arritur për para si dhe në vonesat në përfundim të projektit. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar gabimet. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë realizimi i buxhetit, prokurimi, dosjet e personelit dhe subvencionet.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MAPL dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	4,655,236	4,476,054	3,825,642	4,259,816	4,919,403
Granti i Qeverisë -Buxheti	4,655,236	4,337,251	3,745,283	4,148,756	4,877,197
Donacionet e jashtme	-	137,504	80,359	111,060	42,206

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 179,835€. Kjo lëvizje është rezultat i donacioneve të jashtme, në total prej 137,504€ si dhe i zvogëlimit të aplikuar pas rishikimit buxhetor dhe në pajtim me vendimet e Qeverisë.

Në vitin 2015, MAPL ka përdorur 85% të buxhet final ose 3,825,642€, me një përmirësim prej 3% krahasuar me vitin 2014. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	4,655,236	4,476,055	3,825,642	4,259,816	4,919,403
Pagat dhe Mëditjet	915,383	845,077	844,722	809,979	666,931
Mallrat dhe Shërbimet	310,704	394,508	326,231	446,250	390,365
Shërbimet komunale	25,500	13,574	13,388	18,878	25,724
Subvencionet dhe Transferet	203,649	200,732	200,732	372,007	468,125
Investimet Kapitale	3,200,000	3,022,164	2,440,569	2,612,702	3,368,258

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final për Paga dhe Mëditje në krahasim me buxhetin fillestar është zvogëluar për 70,306€. Fillimisht, kjo kategori është zvogëluar për 93,910€ me rishikim të buxhetit, dhe më pas, në muajin dhjetor është rritur për fondin e kuadrove për 12,280€ dhe për shkak të deficitit është rritur edhe për 11,324€ në fund të vitit. Deri me 31 dhjetor 2015, 100% e buxhetit final është realizuar.
- Buxheti final për Mallra dhe Shërbime në krahasim me buxhetin fillestarë gjithsej është rritur për 83,804€. Fillimisht, është ulur për 56,273€ me rishikim të buxhetit, dhe më pas është rritur në muajin tetor për 3,800€ të cilat janë transferuara nga kategoria e komunalive. Gjithashtu, buxhetit final i janë shtuar edhe 137,504€ nga donacionet e jashtme. Buxheti final për këtë kategori është realizuar 326,231€ apo 83%.
- Buxheti final për Shërbime komunale në krahasim me buxhetin fillestar është zvogëluar për 11,926€. Fillimisht, kjo kategori është zvogëluar për 3,800 € (të cilat janë transferuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve), dhe më pas është zvogëluar në muajin tetor për 8,125 €. 99% e buxhetit final të kësaj kategorie është realizuar.
- Buxheti final për Subvencione dhe Transfere krahasuar me atë fillestarë është zvogëluar për 2,917€. Buxheti final për këtë kategori është realizuar 100%.
- Buxheti final për Investime Kapitale në krahasim me buxhetin fillestar është zvogëluar për 177,836€. Fillimisht, me rishikim të buxhetit kjo kategori është zvogëluar për 12,555€, kurse më vonë është zvogëluar edhe për 166,581€. Pavarësisht zvogëlimit, buxheti final për këtë kategori është shpenzuar vetëm 81%.
Programi për Investime Kapitale përfshin projekte në vazhdim nga viti i kaluar dhe projekte të reja për vitin aktual. Projekti “Rregullimi i shtratit të lumit në Dobrajë të Madhe” Komuna e Lipjanit, si bashkëfinancim në mes të MAPL dhe Komunës së Lipjanit sipas marrëveshjes në shumë prej 157,537 €, nuk ishte finalizuar në vitin 2014 pasi që progresi fizik i projektit nuk ishte në nivelin e pritur, dhe projekti i tillë vazhdoi edhe gjatë vitit 2015, po ashtu për të mos përfunduar as gjatë këtij viti.

Ndërsa gjatë vitit 2015, në bashkëfinancim me Komunën e Rahovecit u investua edhe në ndërtimin e shtëpisë së kulturës në fashtin Xërxë, sipas marrëveshjes së bashkëfinancimit në shumë prej 125,000 €, prej të cilave, 100,000 € investoi MAPL dhe pagesa gjatë vitit prej 88,585 €.

Investime të tjera kapitale u ndërmorrën edhe në Komunën e Zubin Potokut në vlerë të kontratës prej 120,000 € dhe investime gjatë vitit prej 117,777 €, Komunën e Graçanicës në shumën e kontratës prej 199,289, dhe investime gjatë vitit prej 147,324 €, Mitrovicë jugore në shumë të financimit nga ana e Ministrisë prej 180,000 € dhe investime gjatë vitit prej 177,021 €, Komunën e Vitisë investime në vlerë prej 100,000 €, Komunën e Kamenicës investime në vlerë prej 52,000 €, investime në Komunën e Klllokotit në shumën prej 84,446 € dhe disa projekte të tjera.

Çështja 6 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i Lartë

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Realizimi i buxhetit nuk ishte në nivelin e pritur, me një përqindje të realizimit prej 85%. Suficit më të madh ka pasur në kategorinë e investimeve kapitale dhe mallërave dhe shërbimeve, realizimi i të cilave ishte 81% dhe 83%, respektivisht. |
| Rreziku | Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe realizimit i ulët i tij do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm. |
| Rekomandimi 6 | Ministri duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, kjo duhet të reflektohet plotësisht në pozitën e buxhetit final. |

3.4 Prokurimi

Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit të tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi të ndëshkimeve në lidhje me performancën e dobët si dhe përmes sigurisë së ekzekutimit.

Çështja 7 – Dobësitë jo-sistematike të prokurimit – Prioritet i lartë

E gjetura

Nga rishikimi i 7 kontratave, kemi identifikuar se disa kontrole menaxheriale ndaj aktiviteteve të prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë dhe kjo ka rezultuar si më poshtë:

- Nga 7 dosje të ekzaminuara të prokurimit, kemi vërejtur që nuk është praktikë e Ministrisë që të përgatisë një udhëzim të veçantë me shkrim sipas të cilit Zyrtari Autorizues e autorizon Zyrtarin e Prokurimit për fillim e procedurave të prokurimit, pas nënshkrimit të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve, sipas kërkesave të Ligjit mbi Prokurimin Publik, neni 22.
- Për kontratën “Ndërtimi i shtëpisë së kulturës në fshatin Xërxë - Faza e dytë” - Komuna e Rahovecit dhe kontratën “Rregullimi i shtratit të lumit në Dobrajë të Madhe” Komuna e Lipjanit, kishte vonesa në kryerjen e punëve.

Kontrata “Ndërtimi i shtëpisë së kulturës në fshatin Xërxë - Faza e dytë” - Komuna e Rahovecit, ishte nënshkruar më 24 korrik 2015, dhe sipas kontratës punimet do të fillonin brenda tre ditëve nga nënshkrimi i kontratës dhe do të zgjatnin 120 ditë pune. Punimet ishin ndërprerë për shkak të kushteve atmosferike më 24 dhjetor 2015, duke mbetur edhe 17 ditë pune sipas planit dinamik. Punimet rifilluan në vitin 2016, mirëpo deri më datën e punës tonë në terren ende nuk kishin përfunduar.

Ndërsa për kontratën “Rregullimi i shtratit të lumit në Dobrajë të Madhe” Komuna e Lipjanit vonesat ishin edhe më të mëdha. Kontrata ishte nënshkruar më 29 gusht 2014, dhe punimet përfshinin 90 ditë pune (sipas ditëve kalendarike). Mirëpo, përshkak të mbarëvjetjes jo të mirë të punimeve si dhe kërkesave të kontraktorit për zgjatje të afatit të planit dinamik, deri me datën e punës tonë në terren punimet sipas kontratës ende nuk kishin përfunduar.

-
- Për kontratat "Ndërtimi i shtëpisë së kulturës në fshatin Xërxë - Faza e dytë", "Servisimi, Riparimet, pjesët e ndërrimit, ngjyrosjet, dhe pjesët e këmbimit të veturave zyrtare të MAPL-së (e ndarë në LOT)", LOT - 2 dhe LOT - 3, si dhe "Furnizimi me tonerë", konfirmimi i disponueshmërisë së fondeve nuk ishte bërë me një datë pas publikimit për dhënie të kontratës dhe para nënshkrimit të kontratës me kontraktorin, siç kërkohet me Ligjin mbi Prokurimin Publik.
 - Për kontratën "Furnizimi me tonerë" vlera e parashikuar e fondeve sipas Deklaratës së Përcaktimit të Nevojave dhe Disponueshmërisë së fondeve, nuk korrespondonte, respektivisht ishte më e madhe për 3,000 €, se sa vlera e parashikuar sipas Planit të Prokurimit të dorëzuar në AQP.
 - Sipas nenit 15 të Rregullores Financiare Nr. 01/2013/MF, kontrata me furnitorët nuk mund të nënshkruhet pa u bërë zotimi i mjeteve përkatëse për vitin përkatës fiskal sipas kushteve të kontratës. Nga rishikimi i 7 kontratave, kemi identifikuar rastet e mëposhtme ku zotimi i mjeteve nuk është bërë sipas rregullave të përcaktuara:

Për kontratën "Servisimi, Riparimet, pjesët e ndërrimit, ngjyrosjet, dhe pjesët e këmbimit të veturave zyrtare të MAPL-së (e ndarë në LOT)", LOT - 2 dhe LOT - 3, e cila ka datë të nënshkrimit 23 mars 2015 janë bërë dy zotime para nënshkrimit të kontratës në vlerë prej 6,789 € dhe 15,331 €, respektivisht, me data 5 shkurt 2015 dhe 16 shkurt 2015. Megjithatë, më datë 17 nëntor 2015 është bërë edhe një zotim shtesë për mjete prej 1,000 € rreth shpenzimeve të dala nga kjo kontratë.

Për kontratën "Shërbimet e udhëtimit me aeroplan për nevoja të MAPL-së" të datës 14 prill 2015 është bërë një zotim fillestar më datë 1 prill 2015 me vlerë prej 45,495 €. Megjithatë ky zotim është anuluar menjëherë pas nënshkrimit të kontratës. Për të gjitha shpenzimet pasuese nga kjo kontratë kornizë, institucioni ka zotuar mjete në bazë të faturës respektive të pranuar dhe në datën e pranimit të faturës.

Për kontratën "Servisim urgjent i veturës zyrtare Mercedes" të datës 10 shkurt 2015 janë zotuar fillimisht 6,789 € më 5 shkurt 2015. Megjithatë, shumat e faturave të pranuar tejkalojnë shumën e zotuar për 1,131 €, që janë paguar me anë të një zotimi tjetër të datës 16 shkurt 2015 me vlerë 15,331 € që shërben njëherit edhe për kontratën "Servisimi, Riparimet, pjesët e ndërrimit, ngjyrosjet, dhe pjesët e

këmbimit të veturave zyrtare të MAPL-së (e ndarë në LOT)”, LOT – 2 dhe LOT – 3, e cila ka datë të nënshkrimit 23 mars 2015.

Gjatë rishikimit të dosjeve të prokurimeve, kemi vërejtur se pagesat për faturat e lëshuara për shërbimet e kryera janë paguar me vonesë dhe jo brenda 30 ditëve, gjë që është në kundërshtim me rregulloret në fuqi. Kjo gjetje vlen për kontratat “Ndërtimi i shtëpisë së kulturës në fshatin Xërxë - Faza e dytë” - vonesa deri në 7 ditë, “Servisimi, Riparimet, pjesët e ndërrimit, ngjyrosjet, dhe pjesët e këmbimit të veturave zyrtare të MAPL-së (e ndarë në LOT)”, LOT – 2 dhe LOT – 3- vonesa prej 6 ditë. Vlenë të theksohet që kemi vënë re edhe vonesa në pranimin e faturave.

Rreziku Si rezultati i dështimit për të ndjekur procedurat e duhura të prokurimit dhe udhëzuesit përkatës në mënyrë konsistente, mund të bëhen pagesa të parregullta, vonesa në ofrimin e shërbimeve, vlerë e dobët për parane e shpenzuar, si dhe kontratat mund të mos implementohen sipas standardeve të kërkuara.

Rekomandimi 7 Ministri duhet të sigurojë se është kryer një shqyrtim për të përcaktuar pse në rastet e mësipërme kërkesat e prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë. Rrjedhimisht, duhen kontrole të shtuara për të siguruar që një situatë e ngjashme nuk do të përsëritet në prokurimet e ardhshme.

3.5 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.5.1 Avancet, komunalitë dhe shpenzimet tjera

Ne kemi testuar gjithashtu shpenzimet për të cilat nuk kërkohet aplikimi i procedurave të prokurimit siç janë: Shërbimet komunale, shpenzimet e reprezentacionit, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare dhe shpenzime tjera.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë

3.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë nga MAPL kanë të bëjnë me llogaritjen e pagave në pajtim me kontratat e punës si dhe legjislacionit të aplikueshëm.

Numri i aprovuar për të punësuarit në MAPL ishte 141, ndërsa numri aktual i të punësuarve ishte 129 punonjës. Ne kemi testuar disa procedura të rekrutimit, dosjet e personelit si dhe kemi rishikuar listat e pagave dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PVF.

Çështja 8 – Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore – Prioritet i mesëm

E gjetura	Anëtarët e Komisionit të Auditimit, kanë pranuar kompenzim shtesë për mbledhjet e mbajtura nga ky komisioni gjatë vitit. Kjo nuk është në pajtueshmëri me Ligjin, i cili kërkon që “nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, sipas një akti të Qeverisë, kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet tjetër publik, ky punonjës, shërbyes civil ose zyrtar nuk ka të drejtë të pranojë, dhe nuk do të pranojë, kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur”.
Rreziku	Kompenzimi shtesë për mbledhjet e mbajtura nga Komisioni i Auditimit është në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
Rekomandimi 8	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha kompenzimet e bëra janë brenda limiteve dhe në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret përkatëse.

3.5.3 Subvencionet dhe Transferet

MAPL-ja ka zhvilluar procese të mbikëqyrjes dhe monitorimit për subvencione dhe transfere. Megjithatë, këto procese nuk kanë siguruar që subvencionimi të bëhet plotësisht në përputhje me objektivat e përcaktuara.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6 Pasuritë dhe detyrimet

3.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Edhe pse Ministria ka ndërmarrë hapa për të përmirësuar raportimin për pasuritë e saj, ekzistojnë ende disa pasiguri dhe mangësi në lidhje me pasuritë e Ministrisë.

Çështja 9 – Mangësi në menaxhimin e pasurisë – Prioritet i lartë

E gjetura

Regjistri i pasurive kapitale i mbivlerësuar. Ministria realizon investime në komuna. Shuma totale e pasurive që është paraqitur më datë 31 dhjetor 2015, në Shënimin 31: Përmbledhja e pasurive jo-financiare kapitale (me vlerë mbi 1,000 Euro) në posedim të organizatës buxhetore është 7,024,524€. Sipas dokumentacionit që kemi ekzaminuar, dhe rishikimit të informacioneve që kemi marrë nga Ministria, kemi vënë re që prej këtyre pasurive, afërsisht 142,568€ janë pasuri në pronësi dhe shfrytëzim të Ministrisë, ndërsa shuma tjetër prej 6,883,956€ janë investime kapitale që janë realizuar në Komuna, të cilat ende paraqiten si pasuri e Ministrisë, në vend që të bartëshin tek komunat përkatëse, sipas kërkesave të Rregullorës së MF. Nr. 02/2013. Ministria ka kryer pagesën finale për investimin sipas marrëveshjes së financimit ose ka pranuar raportin e Komisionit për pranimin teknik të punëve të projektit, por pavarësisht kësaj nuk ka bartur pasuritë tek Komunat. Investimet e tilla kanë përfunduar para dhe gjatë vitit 2015, konkretisht vitet 2009, 2010, 2012, 2013 dhe 2014.

Zhvlerësimi i pasurisë. Regjistri i pasurive kapitale mbi 1,000 € nuk përmban datën e saktë kur pasuria është vënë në funksion, por vetëm vitin e blerjes së pasurisë. Si rrjedhojë ne nuk kemi mundur të përcaktojmë nëse zhvlerësimi i llogaritur nga sistemi dhe vlera neto, respektivisht, e pasurive e paraqitur në shënimin 31 është e saktë.

Për më tepër, duke pas parasysh që Ministria financon projekte kapitale në Komuna, sipas informacioneve që kemi ekzaminuar, regjistri i pasurive mbi 1,000 €, përmbanë pasuri që në kohën e investimit duhet të ishin regjistruar si pasuri në vijim, sipas kërkesave të Rregullorës së MF. Nr. 02/2013, dhe pas finalizimit dhe dorëzimit të kalonin në kategori përkatëse. Mirëpo pasuritë e tilla me rastin e pagesës u regjistruan menjëherë në kategorinë përkatëse dhe jo fillimisht në kategorinë e investimeve në vijim, dhe rrjedhimisht ishin kalkuluar shpenzime të zhvlerësimit, para se pasuria të fillonte të shfrytëzohej. Kjo rezultoi në pasuri me vlerë të nënvlerësuar dhe shpenzime të zhvlerësimit të mbivlerësuar. Efekti i tillë ishte e pamundur të vlerësohej pas parasysh mangësitë në regjistrin e pasurive.

Inventarizimi dhe vlerësimi i pasurive jo- financiare. Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 Ministria nuk ka kryer inventarizimin e pasurive siç kërkohet me Rregulloren MF-Nr. 02/2013 “Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore” e cila kërkon që “Organizatat buxhetore duhet të kontrollojnë së paku njëherë në vit pasurinë jo financiare për të vërtetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike të pasurisë”. Për më tepër duke pas parasysh që rezultatet e inventarizimi të vitit 2014 nuk janë azhurnuar në sistem, balancat bartëse të pasurive nga viti 2014 në vitin 2015 mund të përmbajnë pasaktësi. Ne kemi bërë verifikimin fizik të disa pasurive në objektin e Ministrisë dhe kemi vënë re që lista e aseteve të Ministrisë mbanë pasuri që nuk ekzistojnë dhe janë bartur në organizata tjera buxhetore.

Barazimi i shtesave në shpenzimet kapitale. Shpenzimet kapitale të vitit 2015 sipas shënimit 11 të pasqyrave financiare janë paraqitur në vlerë prej 2,441,000€, ndërsa totali i pasurive kapitale në shënimin 31 të pasqyrave financiare është 7,024,600€ për vitin 2015. Procesi i barazimit të totalit të balancës përmbyllëse të vitit 2014 (shënimi 31 I PVF), të cilës i janë shtuar investimet kapitale të vitit 2015 (shtesat në investime- shënimi 11) dhe i është zbritur zhvlerësimi i vitit, pas krahasimit me vlerën e pasurive të vitit 2015 të paraqitur në shënimin 31, rezulton në një diferencë prej afërsisht 1,400,000€, të paraqitur më pak në shënimin 31. Sipas komunikimeve me zyrtarët e Ministrisë, diferenca vjen si rezultat i fshirjes së disa pasurive nga regjistri gjatë vitit 2015 dhe bartjes së tyre në komunat përkatëse, për të cilat neve nuk ka qenë e mundur të na ofrohet evidencë dhe informacione se për cilat pasuri bëhet fjalë.

Mos kthimi i pasurisë nga zyrtarët e larguar nga MAPL. Secili zyrtar i OB me rastin e largimit nga puna duhet të kthejë pasurinë me të cilën ka qenë i ngarkuar e cila është në pronësi të OB. Gjatë auditimit tonë kemi identifikuar zyrtarë të larguar nga puna, të cilët nuk kanë kthyer pasurinë me të cilën kanë qenë të ngarkuar.

Rreziku	Mos largimi nga regjistri kontabël i pasurive të cilat nuk janë pronë e MAPL-së ndikon që vlera e pasurisë së prezantuar në PVF të jetë e mbivlerësuar. Për shkak se pasuritë kapitale mbahen në vlerën neto në shpalosjen për pasuritë kapitale në posedim të organizatës buxhetore, kalkulimi jo i duhur i zhvlerësimit mund të ndikojë në paraqitjen jo të drejtë të vlerës neto të pasurive kapitale në këtë shënim. Më tutje, mos kryerja e inventarizimit të pasurisë rezulton në mos evidentimin e gjendjes faktike të pasurive të cilat mund të jenë të dëmtuara apo mungojnë tërësisht. Kjo mund të ndikojë në mbajtjen e pasurive në pasqyrat financiare të cilat mund të mos ekzistojnë ose kanë vlerë më të vogël sesa ajo me të cilën ato mbahen në pasqyrat financiare. Moskthimi i pasurisë nga zyrtarët e larguar nga puna rrit rrezikun që pasuria të keqpërdoret, humbet apo tjetërsohet.
Rekomandimi 9	Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë menaxhimin e pasurisë në përputhje me kërkesat ligjore. Po ashtu e një rëndësie të veçantë është të iniciojë procesin për heqjen e pasurisë nga regjistri kontabël të cilat nuk janë pronë e Ministrisë.

3.6.2 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2015 ishte €28,233. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2016. Në krahasim me vitet paraprake obligimet e papaguara janë zvogëluar dukshëm. Faturat për obligimet e papaguara i takonin muajit nëntor dhe dhjetor 2015.

Çështja 10 - Obligimet e papaguara -Prioritet i mesëm

E gjetura	Ne kemi identifikuar se Ministria nuk ka kryer pagesat për obligimet e saj në afat prej 30 ditësh siç përcaktohet me Rregulloren 02-2013 për raportimin e obligimeve të papaguara për organizatat buxhetore. Faturat në vlerë totale prej 118 € të paraqitura në pasqyra, përfaqësojnë fatura të papaguara për më shumë se 30 ditë.
Rreziku	Si pasojë e vonesave të pagesave, MAPL mund të përballlet me kosto shtesë të interesave e gjobave për vonesat të kërkuara nga palët e treta.
Rekomandimi 10	Ministri duhet të sigurohet se MAPL do të ndërmarrë hapa të mëtijshëm dhe të hartojë plane veprimi për të kryer pagesat brenda periudhës së kërkuar.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	Ministri duhet të sigurojë se zbatohet një proces efektiv gjatë përgatitjes së PVF-ve 2015 i cili adreson dobësitë e identifikuar në PVF 2014. Para dërgimit në Qeveri, PVF duhet të nënshkruhen vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës nga ana e menaxhmentit për të siguruar përmbajtjen dhe saktësinë e PVF.	Të implementuara		
Rekomandimet e vitit paraprak	Ministri duhet të sigurojë se rekomandimet e AP-së trajtohen me kujdes të shtuar nga të gjitha nivelet e përgjegjësive me qëllim të adresimit të tyre të plotë dhe me kohë.		Të adresuara por jo të implementuara	
Qeverisja e mirë	Ministri duhet të rishqyrtoj shkaqet e mos aplikimit të kontrolleve në mënyrë efektive në fushën e pasurisë, subvencioneve dhe menaxhimit të burimeve njerëzore dhe të adresoj dobësitë e theksuara në menaxhimin e tyre. Po ashtu të siguroj që listat kontrolluese vetë vlerësuese si dhe regjistrat e rrezikut shfrytëzohen nga menaxhmenti si mjete të cilat testojnë efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përkrahjen e objektivave të tyre të punës.		Të adresuara por jo të implementuara	

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit	Ministri duhet të sigurojë një vlerësim sistematik të arsyeve në lidhje me nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit që ndërlidhet me investimet kapitale. Procesit të aprovimit të projekteve kapitale duhet ti kushtohet më shumë rëndësi për të gjetur dhe evituar pengesat në fazën e hershme. Po ashtu, të shtoj bashkëpunimin me Komunat me qëllim të rritjes së efikasitetit në kryerjen e obligimeve me kohë nga të dy palët.		Të adresuara por jo të implementuara	
Shpenzimet	Ministri duhet të sigurojë që Sekretari i Përgjithshëm ka ndërmarr veprimet adekuate për planifikimin me kohë të furnizimeve gjatë vitit me qëllim të evitimit të anashkalimit të kërkesave ligjore si dhe të zhvilloj proceset e prokurimit për siguruar transparencë, konkurrencë dhe vlerën për paranë e shpenzuar. Po ashtu, ka shtuar llogaridhënien tek zyrtarët përgjegjës për vlerësimin e ofertave me qëllim që në listën e ngushtë përzgjidhen vetëm OE të cilët kanë të regjistruar dhe kryejnë veprimtarinë përkatëse.		Të adresuara por jo të implementuara	
Shpenzimet	Ministri duhet të sigurojë se ka shtuar llogaridhënien dhe përgjegjësinë tek zyrtarët financiar për tu siguruar që faturat e pranura paguhen brenda afatit kohor ligjor si dhe nga kategoria ekonomike adekuate.		Të adresuara por jo të implementuara	

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
Shpenzimet	Ministri duhet të sigurojë mbylljen e avanseve brenda afatit kohor ligjor si dhe aplikimin e ndalesave në paga në rastet e tejkalimit të limiteve të shpenzimeve të telefonisë fikse dhe mobile. Më tutje, aprovimi i udhëtimeve zyrtare bëhet vetëm në rastet kur ka arsyeshmëri të duhur dhe merret parasysh shpenzimi më racional i mjeteve financiare.	Të implementuara		
Shpenzimet	Ministri duhet të sigurojë se gjatë rekrutimit të stafit respektohen kriteret e konkursit publik për të siguruar se kandidatët e përzgjedhur kanë shkathtësitë dhe përvojën e duhur profesionale për pozitën e caktuar. Po ashtu, avansimi në pozitë i zyrtarëve bëhet nëpërmjet procedurës për avancim. Më tutje, transferi në ndonjë pozitë tjetër të bëhet vetëm pasi zyrtarët kanë kaluar periudhën provuese.	Të implementuara		
Shpenzimet	Ministri duhet të siguroj që subvencionimi bëhet për qëllime të cilat promovojnë qeverisjen lokale.		Të adresuara por jo të implementuara	
Pasuritë dhe detyrimet	Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë menaxhimin e pasurisë në përputhje me kërkesat ligjore. Po ashtu të iniciojë procesin për heqjen e veturave nga regjistri kontabël të cilat nuk janë pronë e ministrisë.			Të pa adresuara
Pasuritë dhe detyrimet	Ministri duhet të sigurojë se zotimi i mjeteve dhe nxjerrja e urdhërblerjeve bëhet para hyrjes në obligime, në mënyrë që vlera e obligimeve të papaguara të ulet në nivel minimal.			Të pa adresuara

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo të implementuara	Të pa adresuara
Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet të sigurojë se aktiviteti i ardhshëm i AB-së duhet të orientohej drejt zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë së auditimit të bazuar në rrezik. Kjo do t'i jepte menaxhmentit siguri vjetore për sa i përket efektivitetit (ose e kundërta) të sistemeve të kontrollit të brendshëm për të gjitha rrjedhat shpenzimeve domethënëse.		Të adresuara por jo të implementuara	
Sistemi i auditimit të brendshëm	Ministri duhet të sigurojë se përfitimi nga puna e auditimit të brendshëm merret në konsideratë duke përgatitur planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të NJAB-it dhe ndërmarrjen e veprimeve konkrete në implementimin e tyre.		Të adresuara por jo të implementuara	

Shtojca IV: Përgjigja e Menaxhmentit ndaj të gjeturave

Te gjeturat	Pajtohem i po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne rast te mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte
E gjetura 1: Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë implementuar nga MAPL.		1. Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm- Të implementura 2. Rekomandimet e vitit paraprak - Ku rekomandim është adresuar dhe implementuar. Rekomandimet e AP MAPL i ka përcjellë tek të gjitha njësitë përgjegjëse në MAPL dhe janë marre në konsideratë gjatë vitit 2016. Gjithashtu janë hartuar planet e veprimit për adresimin e rekomandimeve të AP, gjithashtu janë hartuar edhe planet e veprimit për adresimin edhe të rekomandimeve të auditorit të brendshëm AB. 3. Qeverisja e mirë- Ky rekomandim është adresuar dhe është implementuar në konsultim me menaxhmentin janë hartuar listat vetë vlerësuese pas konsultimeve të ngushta me njësinë harmonizuese në Ministrinë e Financave. MAPL ka finalizuar me kohë listën vetë vlerësuese për v.2016 si dhe listën e rreziqeve për v.2016 dhe për v.2017 në harmoni me procesin e planifikimit buxhetor. MAPL procesin e shfrytëzimit të Subvencioneve e ka proces transparent dhe këtë kategori buxhetore e shpenzon në harmoni me Rregulloren e Subvencioneve.	

Te gjeturat	Pajtohem i po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne rast te mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte
		4. Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit - Ky rekomandim është adresuar dhe ne v.2015 ka pasur rritje të nivelit të shpenzimeve, por për shkak edhe të sqarimeve që janë dhënë në të gjeturat MAPL si dhe 7 ministritë e tjera të linjës e kanë pasur ne buxhet një program për 4 komunat Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin potok i cili është në ndarë në dhe koordinuar edhe me partneret ndërkombëtare dhe implementimi i tij ka filluar ne muajin shtator dhe ka qenë afat i shkurte për shpenzimin e tij. MAPL ka bashkëpunim të mirë me komunat ne fushën dhe asnjëherë nuk hyn në obligime më shumë se sa ka mjete të alokuara ne dispozicion. 5. Shpenzimet - a) Planifikimin me kohë të furnizimeve dhe prokurimi - Është adresuar rekomandimi dhe gjate v.2015 dhe MAPL maksimalisht është munduar qe gjate vitit 2015 mos të ketë prokurime jashtë planit te prokurimit. Transparenca ne fushën e prokurimit konsiderojmë qe është në nivelin e duhur gjitha kërkesat e Operatoreve ekonomik janë adresuar me kohe sa dhe nuk kemi raste kur janë përzgjedhur OE te cilët nuk e kanë veprimtarinë përkatëse. b) Llogaridhënia dhe përgjegjësia tek zyrtarët financiar. Konsiderojmë që ky rekomandim është adresuar dhe është ne implementim e sipër. Të gjitha faturat të cilat vijnë para afatit të lejuar për zotime nga ministria e financave MAPL i adreson me kohë. Ato të cilat vijnë në fund vit regjistrohen si borxhe të cilat MAPL i raporton ne regjistrin e borxheve.	

Te gjeturat	Pajtohem i po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne rast te mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte
		c) Mbylljen e avanseve dhe aplikimi i ndalesave në paga. Të implementura. d) Rekrutimi i stafit - Të implementura. e) Subvencionet - Konsiderojmë që ky rekomandim është implementuar në v.2015 të gjitha subvencionet janë realizuar sipas rregullores se subvencioneve. 6. Menaxhimi i pasurive - Ky rekomandim është adresuar dhe është ne implementim e sipër, MAPL ka finalizuar raportin e zhvlerësimit dhe tjetërsimit te pasurisë. 7. Pasuritë dhe detyrimet - Konsiderojmë që ky rekomandim është adresuar dhe është në implementim e sipër. MAPL nuk hyn në obligime pa mjete te alokuara dhe të zotuar, obligimet e raportuara në listën e borxheve kanë ardhur në MAPL pas afatit te zotimeve. 8. Sistemi i auditimit të brendshëm. a) Strategjia e auditimit të bazuar në rrezik- Të adresuara dhe në proces të zbatimit. b) Plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve të NJAB-it- Të adresuara por jo të implementuara	

Te gjeturat	Pajtohem i po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne rast te mospajtimimit	Pikëpamja e Deloitte
E gjetura 2: Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar katër pyetje kyçe të pyetësorit të vetëvlerësimit në lidhje me komponentet. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se: - Përderisa dokumentimi i rreziqeve në regjistrin përkatës është konsideruar si i vendosur në pytësor, një regjistër i tillë nuk është përpiluar fare për vitin 2015. - Lidhur me procesin e prokurimit, komisioni për hartimin e specifikacionit teknik konsiderohet si i vendosur nga MAPL, mirëpo dëshmitë që na janë dhënë nuk e mbështesin këtë konkluzion.	Jo	MAPL ka hartuar lisën e vetëvlerësimit ashtu siç është evidentuar nga Auditorët dhe pas konsultimeve që MAPL ka pasur në fund të vitit 2015 me Ministrinë e financave. Janë ndërmarrë të gjitha veprimet dhe menaxhmenti i lartë ka përpiluar listën e rreziqeve për vitin 2016 si dhe se gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2017 ka hartuar regjistrin e rreziqeve edhe për vitin 2017. Konsiderojmë se rekomandimi i tillë është adresuar në fillim të vitit 2016. Bazuar ne Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik Pika 9, paragrafi b, Njësia kërkuese përgatitë/proponon Specifikimin teknik, termat e referencës dhe parametrat e punës/Faturën e Sasive. Sipas këtij udhëzuesi, komisionet mund të themelohen në rastet e kontratave komplekse ose të veçanta ashtu siç përcaktohen me Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik Pika 17.7. Duke marrë në konsideratë së MAPL nuk ka pasur në proces të tenderimit ndonjë kontratë komplekse për të cilën nevojitet komision apo kompani për hartim të specifikimit, specifikimi teknik është hartuar gjithmonë nga njësia kërkuese.	

Te gjeturat	Pajtohem i po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne rast te mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte
E gjetura 2 (vazhdim) - Lidhur me përgatitjen e raporteve për zotimet dhe raportet për ekzekutimin e buxhetit, MAPL është përgjigjur se përgatiten në baza javore, mirëpo dokumentimet në mbështetje të këtij konkluzioni janë të dobëta.		Dizivioni i Buxhetiti dhe financave/MAPL përgaditë raporte javore në të cilat gjithë theksohen numri i zotimeve dhe avanseve kurse në baza mujore përgatitë raporte në mënyrë tabelore ku paraqiten në detaje niveli i zotimeve, shpenzimeve për të gjitha kategoritë ekonomike për dy programet e MAPL-së.	E gjetura qëndron.
E gjetura 3: MAPL nuk ka përgatitur regjistrin e rreziqeve për vitin 2015.		MAPL pas konsultimeve që ka pasur në fund të vitit 2015 me Ministrinë e financave, ka ndërmarrë të gjitha veprimet dhe ka përpiluar listën e rreziqeve për vitin 2016 si dhe se gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2017 ka hartuar regjistrin e rreziqeve edhe për vitin 2017. Konsiderojmë se ky rekomandim është adresuar në fillim të vitit 2016. Gjithashtu, konsiderojmë që kjo e gjetur është përmendur në të gjeturën Nr.2 të këtij raporti dhe nuk ka nevojë të përsëritet dy herë.	
E gjetura 4: Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të MAPL-së ka nxjerrë në pah se edhe përkundër raportimeve të rregullta formale nga njësit vartëse për fushën e realizimit të buxhetit, prokurimit, subvencioneve, dhe personelit, ato nuk janë shfrytëzuar në mënyrë efektive nga menaxhmenti për të parandaluar gabimet sistematike në këto fusha.		MAPL ka sistem të rregullt të raportimit të brendshëm në baza javore për të gjitha proceset në MAPL. Bazuar në planin detaj të punës (për secilin departament, divizion, sipas aktiviteteve të parashikuara në mënyrë konkrete sipas javëve), të gjitha njësitë organizative në kuadër të MAPL-së raportojnë në baza të rregullta javore, sipas fushës së përgjegjësisë të tyre. Gjithashtu, në baza tre-mujore, raportohet edhe për pjesën e obligimeve të MAPL-së për implementimin e planit të punës dhe implementimin e vendimeve të Qeverisë. Për të pasur një kontroll më efikas,	E gjetura qëndron.

Te gjeturat	Pajtohem i po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne rast te mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte
E gjetura 4 (vazhdim)		departamenti për koordinim të politikave harton analizën e planit të punës së Ministrisë, në baza tre-mujore. Në fund të vitit publikohet raporti vjetor. Të njëjtat mund të jenë në dispozicion: Raportet: - Raportet javore të të gjitha njësive te MAPL-së - Raportet Tremujore të njësive te MAPL-se; - Raportet vjetore te punës se MAPL-se. - Raportet tremujore për implementimin e planit të punës së Qeverisë; - Analiza për implementimin e planit të punës së MAPL-së në baza tre mujore - Raportet për implmentimin e projekteve kapitale; - Raportet për implementimin e projekteve të financuara nga subvencionet Procesverbalet/ raportet e takimeve: - Procesverbalet e takimeve javore; - Procverbalet e takimeve te Grupeve punuese/komisioneve për adresimin e çështjeve te caktuara.	

Te gjeturat	Pajtohem i po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne rast te mospajtimimit	Pikëpamja e Deloitte
E gjetura 5: Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NJAB: 1. Vetëm katër prej gjashtë raporteve të planifikuara për vitin 2015 janë kryer, ndërsa përveq tyre është kryer edhe një auditim add hoc. 2. Plani për adresimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm përfshin vetëm 3 nga 4 raportet e lëshuara nga auditori i brendshëm gjatë vitit 2015.		Aty ku është përdorur fjala program duhet të zëvendësohet me Plan (Plani për vitin 2015, përfshirë edhe atë Strategjik 2015-2017, i aprovuar, është hartuar mbi bazë risku-rreziku gjatë përcaktimit të prioriteteve të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në pajtueshmëri me qëllimet e MAPL-së); - E gjetura se nga 6 auditimet e planifikuara deri me 31.12.2015 janë realizuar vetëm katër raporte qëndron (ndonëse në vitin 2015 këto dy raporte janë bartur për realizim në planin 2016 ku auditimi në Divizionin e Burimeve Njerëzore është realizuar dhe se ky raport në mënyrë elektronike i është afruar Auditorit të Jashtëm). Megjithatë, në këtë të gjetur duhet të përfshihet edhe realizimi i auditimit ad-hoc sipas kërkesës së ZKA-së-shërbim konsulent, proceduar me Nr. protokoli: 400-97/1, datë 09.02.2015. - Në kuadër të Sistemit të auditimit të brendshëm, opinioni për funksionimin dhe rolin e Komitetit të Auditimit të Brendshëm të jepet në mënyrë të shkoqitur- sidomos për vitin 2015 duke iu referuar trajtimin në Memon e dhënë Menaxhmentit të MAPL-së nga Ekipi i ZAP-it në përfundim të vitit 2015 (ku është shqyrtuar Vendimi Nr. 02-385, datë 10.03.2015 për formimin e KAB-it), si dhe (pas rekomandimit), veprimi i ndërmarr nga Ministri me nxjerrjen e Vendimit tjetër për formimin e ri të Komitetit për Auditim të Brendshëm me Nr. protokoli 02-385/2, datë 23.12.2015.	

Te gjeturat	Pajtohem i po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne rast te mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte
E gjetura 6: Realizimi i buxhetit nuk ishte në nivelin e pritur, me një përqindje të realizimit prej 85%. Suficit më të madh ka pasur në kategorinë e investimeve kapitale dhe mallërave dhe shërbimeve, realizimi i të cilave ishte 81% dhe 83%, respektivisht.		Sa i përket realizimit sipas kategorive buxhetore, realizimi i buxhetit është si vijon: Investime kapitale: MAPL ka arritur që të zotojë 99.46 % të investimeve kapitale si: a) 2,020,000.00 € për projektet të të gjitha komunave që është zotuar 100% dhe shpenzimi arrin vlerën 92.90% b) MAPL njëjtë si edhe 7 ministri tjera duke pasur parasysh procesin e integritetit dhe funksionalizimit të 4 Komunave, si një ndër prioritetet kryesore qeveritare Mitorivicë Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok që në ka financuar projektet në vlerë 1 mil € si pjesë e participimit për financim në kuadër të këtij procesi. Ndarja e këtyre projekteve ka kërkuar një koordinimim ndërministror si dhe konsultim me partnerët ndërkombëtar për shkak të koordinimit ndër-institucional dhe çështjeve të karakterit politik procesi i ndarjes së mjeteve buxhetore ka marrë një kohë më të gjatë dhe ndarja e projekteve është bërë gjatë muajit korrik dhe muajit shtator 2015. Zotimi i mjeteve nga ky fond është bërë në masën 98.38% dhe shpenzimet 56.31 %. Ky shpenzim i ulët i këtij fondi ka ka ardhur si rezultat i kapaciteteve të kufizuara të komunave për të përmbyllur procedurat duke marrë në konsideratë sfidat në kuadër të funksionalizimit të administratave të këtyre komunave, prandaj kjo ndikuar në shpenzimet jo në mase të kënaqshme të investimeve kapitale.	

Te gjeturat	Pajtohem i po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne rast te mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte
E gjetura 6 (vazhdim)		Arsyet e lartcekura mund të dëshmohen edhe me shënimet e takimeve të rregullta dhe takimeve tjera janë mbajtur për të koordinuar procesin e ndarjes dhe implementimit të projekteve në raport me ministritë e linjës dhe katër komunave. Sa i përket kategorisë Mallra dhe shërbime, Përqindja e prezantuar nga Auditori gjeneral nuk korrespondon me shënimet e MAPL-së që janë nxjerrë nga free balance-i si dhe të njëjtat janë të prezantuara në pasqyra financiare d.m.th nuk është vlera 83% por është 95.67 %.	Llogaritja e realizimit të buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është e saktë. E gjetura qëndron.
E gjetura 7: Nga rishikimi i 7 kontratave, kemi identifikuar se disa kontrole menaxheriale ndaj aktiviteteve të prokurimit nuk janë zbatuar me konsistencë. Ju lutem referohuni tek Çështja 7.		Pas rekomandimeve të Auditorit të brendshëm në vitin 2014 MAPL për cdo kërkesë të njësive kërkuese për inicim të aktivitetit të prokurimit Furnizim/shërbim dhe punë ka një shkresë standarde që e aplikohet dhe cila drejtohet nga zyrtari i njësisë kërkuese tek sekretari i Përgjithshëm për aprovim. iPasi të miratohet tek SP shkresa vazhdon tek Divizioni i Prokurimit për aprovim që konfirmon se dokumentacioni është i kompletuar dhe fillon me aktivitetin e prokurimit.	

Te gjeturat	Pajtohem i po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne rast te mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte
E gjetura 7 (vazhdim)		Meqenese tani rekomandohet nga Auditori Gjeneral edhe një shkresë nga zyrtari autorizues MAPL do të adresojë këtë rekomandim por ne kemi konsideruar që Sekretari i përgjithshëm është ZKA dhe është autorizues i gjithë buxhetit të MAPL-së. - Kontrata e ndërtimit te shtëpisë se kulturës ne fshatin Xerxe-Faza e dytë projekti është përmbyllur konform kontratës (sepse sipas kontratës, projekti është paraparë që të përmbyllet në vitin 2016) dhe brenda planit dinamik dhe afatit për implementimin e projektit. i Për këtë projekt është bërë pranimi teknik dhe është në proces pagesa përfundimtare. i (Bashkangjitur eshte raporti i komisionit te pranimi teknik dhe raporti i projekt menaxherit). - Kontrata e projektit rregullimi i shtratit te lumit në Dobrajë të madhe në Komunën e Lipjanit komuna e lipjanit ashtu sic e keni përshkruar eshte projekt qe nuk eshte permyllur ende si rezultat i vonesave ne implementim nga Operatori Ekonomik. Sidoqoftë MAPL ka evidentuar të gjitha problemet dhe ka ndërmarrë të gjitha masat për kontrollin dhe menaxhimin e këtij procesi.	E gjetura qëndron.

Te gjeturat	Pajtohem i po/jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne rast te mospajtimit	Pikëpamja e Deloitte
